

RAPORTI PERFUNDIMTAR I
GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT

MASTER I SHKENCAVE NË GJUHË DHE
LETËRSI ANGLEZE

TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “HËNA E
PLOTË” (BEDËR)

Ekspertë: **1 Dr. Violeta Shaba**
2 Dr. Leonard Danglli

Prill 2013

Parathënie për Procesin e Vlerësimit të Jashtëm

I. GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

- Përbërja e GVJ:
 - 1 Dr. Violeta Shaba
 - 2 Dr. Leonard Danglli

II. PARIMET E PUNËS SË GVJ

- Besimi
- Vlerësimi i mbështetur në dokumenta të paraqitura nga GVJ, Institucioni etj.
- Profesionalizmi, vërtetësia,
- Objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe
- Përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.

Objektivat kryesore të procesit të vlerësimit janë:

- Të zbulojë fakte që bëjnë sa më të qartë gjendjen e një institucioni, apo programi studimi në Arsimin e Lartë, në kohë reale dhe në kontekstin kombëtar e ndërkombëtar
- Të bëjë publik informacionin, me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për cilësinë e IAL, programeve të studimit, diplomave e shërbimeve që ato ofrojnë
- Të japë një bazë të mjaftueshme të dhënash, rekomandimesh e konsideratash profesionale, që do të shërbejnë si pikënisje për procesin e mëtejshëm të akreditimit.
- Të shërbejë për kultivimin e kulturës së cilësisë në IAL e cila shihet në ndërtimin e strukturave, praktikave dhe procedurave të brendshme të vlerësimit të cilësisë, struktura të cilat kombinojnë eksperiencën e fituar gjatë vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.

III. ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË JASHTËM

- Miratimi i kërkesës së IAL dhe përcaktimi i afateve kohore të Vlerësimit të Jashtëm
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) nga APAAL dhe miratimi i përbërjes së tij në KA. APAAL mori pjesë me anëtarë, sipas madhësisë së grupit.
- Njoftimi i IAL për përbërjen e GVJ dhe afatet kohore të Vlerësimit të Jashtëm
- Kontraktimi i anëtarëve të GVJ
- Trainimi i GVJ nga stafi i APAAL dhe njohja me Dosjen e Vetëvlerësimit
- Hartimi nga APAAL i programit të vizitës/ave në vend (axhenda) nga GVJ.
- Njoftimi i titullarit të IAL për programin që do të ndjekë GVJ gjatë vizitave në këtë institucion
- Kryerja e procesit të vlerësimit të jashtëm (shih më poshtë).
- Dorëzimi i Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm nga GVJ.
- Dërgimimi i Draft-Raportit të GVJ në IAL
- Ardhja e vërejtjeve/Miratimit të IAL për draft RVJ
- Dorëzimi i Raportit përfundimtar të Vlerësimit të Jashtëm

IV. PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

RVJ mund të përbëhet nga 12 Rubrika kryesore. Cdo rubrikë që kërkohet të analizohet mund të përbëhet nga tre pjesë:

- ❖ Pjesa përshkrimore
- ❖ Tregues të matshëm (Të dhëna, shoqëruar me Anekset).
- ❖ Vlerësimi sipas Standardeve

Në pjesën përshkrimore, GVJ sipas termave të referencës përshkruan aspektin përkatës të vlerësimit. Në pjesën e treguesve të matshëm GVJ do të japë të dhëna sasiore, tabela etj, të cilat vërtetojnë përfundimet e pjesës përshkrimore. Ndërsa në pjesën e vlerësimit cilësor sipas standardeve, GVJ do të përgjigjet konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, nëse plotësohet apo jo.

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM **Për Programin e studimit MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze**

HYRJE

Me urdhër nr. 330, datë 07.08.2012, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, u vendos hapja në përputhje me vendimin nr. 351, datë 13.07.2012, të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare jopublike “Hëna e Plotë” (Bedër), të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) është pjesë përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Në përputhje me “Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e gjuhës dhe letërsisë angleze.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

- Përbërja e GVJ:
 - 1 Dr. Violeta Shaba
 - 2 Dr. Leonard Danglli

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Duke iu referuar rregullores së studimeve Master i Shkencave “Gjuhë dhe letërsi angleze” të shkollës së lartë “Hëna e plotë” (Bedër), ky program synon të përfshijë të gjitha llojet e aspekteve praktike dhe teorike të fushës së studimit dhe synon të pajisë studentët me një sfond teorik për t'u bërë ekspertë në filologji dhe letërsi.

Studentët që do të mbarojnë programet e studimit master shkencor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze do të kenë mundësi të punësohen apo të vijnë në karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh private apo publike që kanë marrëdhënie me gjuhën dhe letërsinë angleze duke përfshirë redaktimin, përkthimin apo mësimdhënien në arsimin e lartë.

Synimet kryesore të programit janë:

- të përgatisë të diplomuar me aftësi të thella në gjuhën angleze dhe letërsinë e shkruar në këtë gjuhë
- të përgatisë njerëz të aftë për të punuar në sektorin e përzgjedhjes dhe redaktimit të letërsisë së shkruar në këtë gjuhë

- të përgatisë studentë të aftë për të analizuar historinë dhe kulturën e vendeve anglishtfolëse
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik dhe analizës letrare
- të përgatisë studentë të aftë për të vlerësuar dhe kryer studime shkencore në këtë fushë

Përçimi tek studentët i njohurive të nivelit universitar, të përditësuara këto në fushat e sipërpërmendura, i pajisin ata me njohuri të cilat u japin mundësinë për të vazhduar studimet e thelluara në disiplinat e shkencave humane, brenda dhe jashtë vendit.

Misioni i Programit Master në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e gjuhës, letërsisë dhe kulturës angleze që angazhohen në aktivitete profesionale dhe kërkimore nëpërmjet një filozofie që ka në thelb vlerat universale.

Duke paraqitur para studentëve programe të kompletuara me të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë profesionale në gjuhën dhe letërsinë angleze, departamenti qëndron fort në misionin e tij për të edukuar, për të zgjeruar njohuritë rreth fushës, për të përgatitur studentët për njohjen e thellë dhe analizën e veprave letrare të shkruara në këtë gjuhë duke i shoqëruar ato me analizën e kulturës dhe gjuhës në të cilën ato janë shkruar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi i IAL sipas standardit/kriterit¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.		
Kriteri 3	Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Kriteri 3: Programi i studimeve rezulton në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Kriteri 4: Programi i studimeve është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës pas një studimi të kryer nga institucioni. Kriteri 5: Zhvillimi ekonomik i vendit tonë ka nevojë për të diplomuar nga ky program studimi veçanërisht në fusha të tilla si përkthime letrare, specialistë të letërsisë etj. Kriteri 6: Programi i studimit “Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi angleze” pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.
Kriteri 4	Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5	Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6	Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.		
Kriteri 1	Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Kriteri 1: Programi i studimit “Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi angleze” është në përputhje me strategjinë e shkollës së lartë “Hëna e plotë” (Bedër) për arritjen e objektivave kryesore të institucionit.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

Kriteri 1	Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Kriteri 1: Programi i studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Kriteri 2	Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Kriteri 2: Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.		
Kriteri 1	Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;	Kriteri 1: Ekziston një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimeve.
Kriteri 2	Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Kriteri 2: Shkolla e lartë “Hëna e plotë” (Bedër) ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.
Konkluzionet e vlerësimit:		
Pas realizimit të vlerësimit të jashtëm, GVJ-ja arriti në përfundimin se standardet e parashikuara përmbushen nga programi i studimit. Rekomandojmë që programi i studimit të pasurohet me lëndë të formimit gjuhësor të cilat janë të lidhura ngushtë me objektivat e punësimit të këtij programi studimi, të tilla si stilistikë, por edhe lëndë përkthimi të detyruar.		

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Tregues të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Fakulteti

SHLHPB ka dy fakultete: Fakultetin e Shkencave Humane dhe Fakultetin e Filologjisë dhe të Edukimit. Fakulteti është njësi kryesore e shkollës së lartë “ Hëna e plotë” (Bedër) që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë. Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit janë: Dekani, Kancelari, Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Administrimit të Fakultetit.

Departamenti	Përgjegjësit e departamenteve
Departamenti i Shkencave të Edukimit	Dr. Ahmet Ecirli
Departamenti i Gjuhë dhe Letërsisë Angleze	Dr. Hasan Uğur
Departamenti i Gjuhë dhe Letërsisë Turke	Dr. Adem Balaban

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Politika e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë (Bedër)” është të tërheqë staf të kualifikuar, kryesisht me grada shkencore e tituj shkencorë dhe standard i përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit. Për të plotësuar nevojat për staf akademik me tituj shkencorë e grada shkencore, është kombinuar punësimi i profesionistëve vendas me të huaj me përvojë në fushën akademike.

Gjatë vitit akademik 2011-2012, në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) janë angazhuar 46 pedagogë (efektivë dhe të ftuar) për 187 studentë. Raporti student- pedagog është 4.1, duke mundësuar punën intensive me studentët për të mbështetur e monitoruar nga afër, vit pas viti, rritjen e tyre cilësore e profesionale.

Për vitin akademik 2012-2013, në Fakultetin e Shkencave Humane, raporti studentë/pedagogë është 236 studentë/53 pedagogë, pra 4.45, ndërsa në Fakultetin e Edukimit dhe të Filologjisë, ky raport është 251 studentë/44 pedagogë, pra 5.72.

Për gjithë Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), raporti në fjalë gjatë semestrit të vjeshtës 2012-2013 është 487 studentë/ 97 pedagogë, pra 5.03. 22

Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit
- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 1- 2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)
- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (plotëso Tabelën 3)

Pedagogët që mbulojnë programin Master i Shkencave “Gjuhë dhe letërsi angleze”

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
	1. Elida Tabaku	Prof.Asoc.	UT
	2. Artur Jaupaj	Dr	CIT (Canadian Institute of Technology)
	3. Bavjola Shatro	Dr	UAMD
	4. Iris Kokoli	Dr	UT
	5. Tidita Abdurrahmani	Dr	
	6. Rregjina Gokaj	Dr	UAMD
1. Ahmet Ecirli		Dr	
2. Yakup Cetin		Dr	
3.Recep Sahin Arslan		Dr	

Raporti midis personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë

Titulli	Dep 1		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	-	-	0/0
Profesorë të As.	-	1	0/1
Doktorë	3	5	3/5
Docentë	-	-	0/0
Pedagogë (pa tituj)	-	-	0/0
Asistentë me Ma	-	-	0/0
Asistentë pa Ma	-	-	0/0
Personeli Administrativ	1		1/0

- Të dhënat sipas seksit
- Të dhëna sipas moshës së personelit
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Të dhëna sipas gjinisë

Titulli	Programi i studimit Master i Shkencave "Gjuhë dhe Letërsi Angleze"		
	PAK femra	PAK meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	0	0/0
Profesorë të asociuar	1	0	0/1
Doktorë	4	1	1/4
Pedagogë doktorantë	0	0	0/0
Pedagogë (pa tituj) me Ma	0	0	0/0
Asistentë me Ma	0	0	0

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.		
Kriteri 1	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Kriteri 1: Nga verifikimet e kryera rezultoi se: Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programit të studimeve dhe për arritjen e tyre. Kriteri 2: Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.
Kriteri 2	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e		

politikave të zhvillimit të institucionit.		
Kriteri 1	Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Kriteri 1: Nga intervistat e kryera u konstatua se personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programit të studimeve.
Kriteri 2	Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Kriteri 2: Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.		
Kriteri 1	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Kriteri 1: Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren.
Kriteri 2	Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	Kriteri 2: Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimeve nuk përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimit.
Kriteri 3	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Kriteri 3: Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;
Kriteri 4	Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Kriteri 4: Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.		
Kriteri 1	Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Kriteri 1: Përgjegjësi i programit ka gradën shkencore “Doktor”.
Kriteri 2	Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Kriteri 2: Titullari i lëndës/modulit në programin e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.
Kriteri 3	Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Kriteri 3: Programi i studimit që është objekt i vlerësimit është Master Shkencor.
Kriteri 4	Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani,	Kriteri 4: Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve.

Kriteri 5	zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve; Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Kriteri 5: Programi i studimeve nuk ofron praktikë profesionale.
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.		
Kriteri 1 Kriteri 2 Kriteri 3	Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli; Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”; Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Kriteri 1: Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, në nenin 16 të saj, parashikon se studentët që ndjekin këtë program studimesh kanë një udhëheqës për punë kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Aktualisht nuk ka të dhëna konkrete udhëheqjesh tezash, pasi po realizohet viti i parë i studimeve në këtë program. Kriteri 2: Në bazë të rregullores udhëheqësi i tezes ka të paktën gradën shkencore ‘Doktor’. Megjithatë, deri tani nuk ka udhëheqje të realizuara. Kriteri 3: Në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi angleze”, shprehet se udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.		
Kriteri 1 Kriteri 2	Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Kriteri 1: Neni 16 i rregullores së studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi angleze” parashikon se fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Kriteri 2: Parashikohet gjithashtu që udhëheqësi të ketë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.		
Kriteri 1	Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Kriteri 1: Ndonëse institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin cilësor të orëve mësimore është e nevojshme ngritja dhe funksionimi i laboratorit të gjuhëve të huaja. Kjo është parashikuar të realizohet brenda vitit akademik 2012-2013. Kriteri 2: Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.
Kriteri 2	Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kriteri 1	Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	Kriteri 1: Në bazë të udhëzimit mbi ngarkesën mësimore, ngarkesa mësimore e stafit akademik realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Kriteri 2: Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre vlerësohen me orë mësimore.
Kriteri 2	Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.		
Kriteri 1	Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Kriteri 1: Nga verifikimet e kryera rezulton se institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit; Kriteri 2: Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ; Kriteri 3: Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.
Kriteri 2	Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	
Kriteri 3	Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Grupi i vlerësimit të jashtëm, pas verifikimeve të kryera dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, arriti në përfundimin se në përgjithësi përmbushen standardet e kërkuara, por duhet të punohet më tej në drejtim të përmbushjes së kriterit 2, standardi III.1.		

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) është vendosur në Tiranë dhe ka një sipërfaqe prej 3945 m², të shpërndara në 9 kate, nga të cilët, një nëntokësor. Qëllimi i përdorimit dhe zonat e mbyllura të përdorura në vitin akademik 2011-2012 janë dhënë në tabelën e mëposhtme

Tregues të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore / profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyre informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vitit akademik 2012-2013, në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) janë përdorur dhjetë klasa. Përveç klasave, tre auditorët janë duke u përdorur vazhdimisht për zhvillimin e procesit arsimor. Klasat janë të kondicionuara. Klasat, janë të pajisura me projektor, dërrasë interaktive dhe kompjuter.

Klasat e përdorura gjatë vitit akademik 2012-2013

Numri i klasës	Hapësira e brendshme (m ²)	Kapaciteti
302	40	26
303	40	26
402	40	26
403	40	26
502	40	26
503	40	26
601	24	18
602	40	28
603	40	24
604	20	12

Numri i auditoreve, sipërfaqja e përgjithshme (m2) dhe kapaciteti

Gjatë vitit akademik 2012-2013, në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) janë duke u përdorur tre auditorë. Auditorët janë të kondicionuar dhe të pajisur me projektor dhe kompjuter.

Auditorët e përdorur gjatë vitit akademik 2012-2013

Emri i auditorëve	Hapësira e brendshme (m2)	Kapaciteti
301	90	56
401	90	56
501	90	56

Salla 402 shërben si laborator kompjuterik dhe në të janë vendosur 24 kompjutera.

Numri i sallave të konferencave dhe kapaciteti

Salla e konferencave (H1), ka një sipërfaqe prej 200 m2 dhe një kapacitet për e 190 veta. Salla e konferencave është përdorur më shumë për veprimtari sociale dhe kulturore.

Biblioteka

Biblioteka e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) funksionon si pjesë përbërëse e institucionit. Biblioteka është në katin e parë dhe ka një sipërfaqe prej 200 metra katrorë. Qëllimi i themelimit të bibliotekës është për të mbështetur aktivitetet arsimore dhe kërkimore të stafit akademik dhe studentëve. Biblioteka është në hyrje të Shkollës dhe ka një sallë leximi me një kapacitet prej 56 vendesh. Biblioteka ka një fond të caktuar me libra për degët përkatëse.

Shërbime të tjera për studentët

Në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), një nga laboratorët kompjuterikë dhe një nga klasat janë ndarë për punën e studentëve gjatë kohës së tyre të lirë. Në të njëjtën kohë, studentët mund të studiojnë në sallën e leximit të bibliotekës së Shkollës. Një printer dhe një qendër fotokopjeje janë vendosur në katin e parë të Shkollës.

Mjediset e fakultetit

Mjediset për Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit	Sasia	Sipërfaqja	Norma m2/për student
Salla për leksione	3	123.2	0.48
Klasa për seminare	2	192.4	0.76
Salla për veprimtari promovuese	0		
Salla për praktikë lëndore / profesionale	0		
Laboratorë për lëndët	0		
Laboratorë informatike	1	44.6	0.17
Salla interneti	0		
Salla për bibliotekë	1	189	0.75
Mjedise për fotokopjime, librari etj	1	15.9	
Zyra informacioni për studentët	1	33	
Korridore/holle	2	84	0.3
Mjedise sportive	0		
Mjedise shërbimi për të tretë			
Mjedisi hidrosanitare për studentët	3	7.5	

Mjedisi hidrosanitare për personelin akademik	2	5.12	
Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja	Norma m²/për person
Zyrë për dekanin/zëvendësdekanin	1	30.9	
Zyrë për kancelarin	0		
Zyra për sekretarinë mësimore	1	25.9	
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	0		
Zyra për personelin akademik	4	90	2.04
Zyrë për financën	0		
Zyrë për Njësinë e SBC			
Salla për mbledhje	0		
Mjedis për stafin e shërbimit	0		
Mjedise për veprimtaritë e qeverisë studentore	0		
Mjedise çlodhëse, si kafeteri/ fastfood/ restorant	1	120.5	0.35

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.		
Kriteri 1	Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Kriteri 1: SHLHPB ka një vendndodhje që disponon mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.
Kriteri 2	Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Kriteri 2: Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për një periudhë afatgjatë, sipas kontratës së nënshkruar.
Kriteri 3	Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Kriteri 3: Programet aktuale të studimit ofrohen në një godinë të vetme.
Kriteri 4	Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Kriteri 4: Institucioni nuk ofron praktika profesionale për këtë program studimesh.
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.		

Kriteri 1	Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	Kriteri 1: Institucioni siguron pjesërisht tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në shërbim të studentëve të programit të studimit.
Kriteri 2	Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Kriteri 2: Biblioteka nuk arrin të mbulojë plotësisht nevojat e studentëve për literaturën e nevojshme për këtë program studimi.
Kriteri 3	Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Kriteri 3: Për të lehtësuar kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, nga viti akademik 2012-2013 është realizuar abonimi me databaza elektronike shkencore online në bibliotekën online Jstore.
Kriteri 4	Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;	Kriteri 3: Përgjegjësit e programit planifikojnë shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;
Kriteri 5	Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Kriteri 5: Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1	Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	Kriteri 1: Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.
Kriteri 2	Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Kriteri 2: Pas vizitës në institucion u verifikua se pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.
Kriteri 3	Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	Kriteri 3: Planifikohet të ngrihet laborator i gjuhëve të huaja në shërbim të studentëve të programit të studimit.
Kriteri 4	Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	Kriteri 4: Programi nuk parashikon praktika laboratorike.

Konkluzionet e vlerësimit:

Pas përfundimit të vizitave në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ-ja arrin në përfundimin se përgjithësisht përmbushen kriteret e përcaktuara, por i duhet kushtuar rëndësi e veçantë pasurimit të bibliotekës me literaturën e nevojshme për mbulimin e lëndëve të programit të studimit.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) është institucion privat jofitimprurës. Ky status specifikohet në statusin e SHLHPB. Institucioni ka të drejtë të pranojë mbështetje financiare dhe materiale që lidhet me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Në bazë të dispozitave të ligjit nr. 10056, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjella”, Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) është e përjashtuar nga pagimi i taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera ndaj shtetit.

Veprimtaria ekonomike

Administrimi, manaxhimi dhe financimi i Shkollës pasqyrohen në bilance. Institucioni mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Kryetari i Këshillit të Lartë është drejtori financiar i Shkollës së Lartë. Ai mund ta delegojë disa ose të gjitha kompetencat njërit prej anëtarëve të Këshillit të Lartë, rektorit, dekanëve ose drejtuesve të tjerë të Shkollës.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**
 - Grantet për kërkim
 - Konsulencat, shërbimet
 - Tarifat për dhe gjatë shkollimit
 - Sponsorizimet
 - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
 - Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
 - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p>	<p>Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Kriteri 1:Raporti i auditit nuk është hartuar ende, pasi nuk është përfunduar viti i parë i programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2: Nuk ka të dhëna lidhur me raportin e auditit, pasi nuk është përfunduar viti i parë i programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3: Nuk ka të dhëna lidhur me raportin e auditit, pasi nuk është përfunduar viti i parë i programit të studimit.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;</p> <p>Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Kriteri 1: Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj</p> <p>Kriteri 2: Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Duke qenë se është duke u realizuar viti i parë akademik i programit të studimit nuk ka të dhëna lidhur me auditimin apo raportin e përvitshëm mbi situatën financiare.</p>		

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë është organi përgjegjës për monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të menaxhimit dhe vlerësimit akademik dhe administrativ zhvillimin e cilësisë, planifikimin strategjik, vlerësimin institucional, vlerësimin e jashtëm, kontrollin periodik dhe periudhën e përmirësimit në Shkollën e Lartë "Hëna e plotë" Bedër.

Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë ka në strukturën e tij 3 komisione autonome të miratuara nga Senati, për kryerjen e detyrave të caktuara prej këtij të fundit,

ku Komisioni i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë (KBSC) është komision i ngritur në Institucion me qëllim vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore - zhvillimore, si dhe të veprimtarive administrative e financiare të institucionit. Komisioni i brendshëm i sigurimit të cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. KBSC i bën pjesë integrale të organizimit dhe funksionimit të saj të gjitha standardet e vendosura nga organizmat të cilat do të garantojnë “çertifikimin e cilësisë”, duke marrë në konsideratë parashikimet dhe detyrimet që lindin nga karta e Bolonjës dhe legjislacioni në fuqi.

Tregues të matshëm:

Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Bayram Karçi	Kryetar	27.02.2012
2	Ramadan Çipuri	Zv. Kryetar	27.02.2012
3	Prof. As. Dr. Rahim Ombashi	Anëtar	10.10.2012
4	Manjola Çollaku	Anëtar	27.02.2012
5	Arti Omeri	Anëtar	27.02.2012
6	Albi Koçibelli	Anëtar	27.02.2012
7	Nertil Bërdufi	Anëtar	10.10.2012
8	Enriketa Sögütlü	Anëtar	10.10.2012
9	Gentjan Skara	Sekretar	27.02.2012

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qënë hapat e mëtejshëm
- Etj

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1	Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;
Kriteri 2	Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.
	Kriteri 1: S'ka të dhëna, pasi viti akademik nuk ka përfunduar ende. Kriteri 2: Mbështetur në planin strategjik të shkollës së lartë “Hëna e plotë” (Bedër), institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programit të studimeve të ciklit të dytë.
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p> <p>Kriteri 5</p> <p>Kriteri 6</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Kriteri 1: Institucioni është akredituar në nivel institucional.</p> <p>Kriteri 2: Programet e studimeve përmirësohen më tej duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. Pas çdo rezultati të siguruar nga anketimi me studentë, në bazë departamenti, bëhet rivlerësimi i brendisë së lëndës, i cili dërgohet për miratimin në Këshillin e fakultetit, për t'u miratuar më pas nga Senati.</p> <p>Metodat e tërthorta të vlerësimit janë zbatuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë ku ka pasur seksione të veçanta mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës. Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga SHLHPB Pyetje konceptuale Rekomandime nga studentët <p>Metoda të drejpërdrejta janë ato të të përfshira edhe në programin e lëndës si:</p> <ol style="list-style-type: none"> Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor; Vlerësime me notë dhe me pikë; Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët; Vlerësim për përfshirjen në aktivitete jashtë shkollore. <p>Kriteri 3: Institucioni ndjek një politikë dhe zbaton procedura që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>Kriteri 4: Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit. Ndryshimet në programet mësimore ndjekin një hierarki të caktuar duke filluar me departamentin dhe duke vazhduar me fakultetin deri tek organi kolegjal vendimmarrës i shkollës së lartë "Hëna e plotë" (Bedër), Senati. Gjithashtu, procesi i ndryshimit të kurrikulave realizohet nën bashkërendimin e zyrës së menaxhimit të kurrikulave.</p> <p>Kriteri 5: Institucioni synon</p>
---	---	--

		<p>ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Është me rëndësi të përmenden guida studentore dhe guida e stafit, në të cilat vihet në dukje rëndësia e cilësisë dhe siguri i saj në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Kriteri 6: Institucioni ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat rezultojnë të publikuara.</p>
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p>	<p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare /ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë 	<p>Kriteri 1: Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë, nëpërmjet komisioneve të tij vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe administrative të programit. Komisionet kanë akses në të gjitha të dhënat e Institucionit dhe publikojnë rezultatet e vlerësimit të kryer.</p> <p>Kriteri 2: Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Kriteri 3: Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë.</p> <p>Kriteri 4: Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimit. Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura, studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe brendinë e lëndës. Metodatat e tërthorta të vlerësimit janë zbatuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë e cila përmbante:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës. Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës. Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga SHLHPB. Pyetje konceptuale. Rekomandime nga studentët. <p>Metoda të drejtpërdrejta janë ato të të përfshira edhe në programet</p>

	<p>zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>lëndore si:</p> <p>f. Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor;</p> <p>g. Vlerësime me notë dhe me pikë;</p> <p>h. Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët;</p> <p>i. Vlerësim për përfshirjen në aktivitete jashtë shkollore;</p> <p>Një tjetër anketim i zhvilluar është ai me anëtarët e stafit akademik dhe administrativ, të cilët në mënyrë periodike japin mendimet e tyre në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe administrativ brenda SHLHPB.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>		
<p>Kriteri 1</p>	<p>Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>Kriteri 1: Institucioni ka publikuar në faqen e tij të internetit raportin e vlerësimin të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Kriteri 2: Institucioni parashikon të publikojë rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në institucion GVJ-ja konfirmon përputhshmërinë midis standardeve të përcaktuara dhe realizimit ose parashikimit të realizimit të tyre nga programi i studimit “Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi angleze”.</p>		

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni

Misioni i Departamentit të Gjuhë dhe Letërsisë Angleze është përgatitja e individëve me njohuri të thella në fushën e gjuhës dhe letërsisë angleze, zhvillimi i të menduarit kritik dhe aftësive të komunikimit në këtë gjuhë për të kuptuar dhe zbërthyer botën ku jetojmë. Ne synojmë të përgatisim profesionistë të zotë me interes për dijen dhe kërkimin shkencor, që do të mund të përballojnë me sukses sfidat e shekullit të 21 në shërbim të shoqërisë dhe vlerave universale.

Vizioni

Vizioni i departamentit është përgatitja e profesionistëve të aftë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet gërshtimit të mirëorganizuar të anës teorike me atë praktike.

Mundësitë e punësimit

- Studenti mund të punojë si përkthyes në administratën publike dhe organizata vendase e ndërkombëtare etj.
- Studenti mund të punojë si redaktues dhe kritik letrar në media dhe shtëpi botuese.
- Studenti me formim të tillë mund të punojë gjithashtu si ekspert i letërsisë dhe kulturës anglishtfolëse në medianë e shkruar apo vizive
- Studenti mund të punojë si specialist i marëdhënieve ndërkulturore në organizata qeveritare dhe OJF të ndryshme

Rreth programit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Programi *Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze* është projektuar t'u ofrojë studentëve një formim intelektual, duke përfshirë të gjitha llojet e aspekteve praktike dhe teorike të fushës së studimit për të përgatitur ekspertë në filologji, linguistikë dhe letërsinë Angleze.

Programi ka për qëllim të pajisë studentët me një gamë të gjërë njohurish dhe konceptesh në fushën e gjuhës, letërsisë dhe kulturës së vendeve anglishtfolëse.

Viti i fillimit dhe objektivat formues të programit

Programi Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze u hap në vitin akademik 2012-2013. Objektivat formuese të programit parashikohen në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, neni 3 i saj. Programi përgatit specialistë të aftë për të vlerësuar, redaktuar dhe përkthyer letërsinë e shkruar në gjuhën angleze si dhe do të përgatisë specialistë të gjuhës dhe kulturës angleze. Studentët që do të mbarojnë programet e studimit master shkencor në gjuhë dhe letërsi angleze do të kenë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale në një sërë sektorësh apo organesh private apo publike që kanë marëdhënie me gjuhën dhe letërsinë angleze.

Objektivat kryesore të programit janë:

- të përgatisë të diplomuar të suksesshëm me aftësi të thella në gjuhën angleze dhe letërsinë e shkruar në këtë gjuhë;
- të përgatisë njerëz të aftë për të punuar në sektorin e përzgjedhjes dhe redaktimit të letërsisë së shkruar në këtë gjuhë
- të përgatisë studentë të aftë për të analizuar historinë dhe kulturën e vendeve anglishtfolëse
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, analizës letrare dhe studimeve shkencore në këtë fushë
- të aftësojë studentët në analizën dhe aplikimin e njohurive dhe aftësive të fituara në shërbim të arsimit, kërkimit shkencor dhe zhvillimit ekonomik e social.

Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)

Parashikuar në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të dytë dhe në Rregulloren e ciklit të dytë të Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, neni 4, programet në fjalë organizohen sipas sistemit me kohë të plotë.

Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me vendim Këshillit të Fakultetit dhe miratur me vendim të Senatit Akademik të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër).

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve përfundimtare
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

Emërtimi i Diplomës për çdo programi studimi

Emërtimi i diplomës së fituar nga studenti që përfundon studimet në programet master i shkencave parashikohet në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë të SHLHPB, neni 6 i saj, si dhe në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë Master në Shkenca i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, neni 4 mbi organizimin e studimeve. Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze pajisen me diplomë **“Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”**.

Viti I Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore														Gjithsej		
			Leksione			Seminar e			Laborat or			Praktik ë			Orë në auditor	Punë e Pavarur		Provime	
			ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur					
Qasje në kritikën letrare	I	6	5	64	61	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	61	25	150
Letërsi kulturë britanike dhe	I	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Letërsi kulturë amerikane dhe	I	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Letërsi post koloniale	I	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Lëndë me zgjedhje																			
Psikolinguistikë	I	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Letërsia dhe Kultura mesjetare	I	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Zhvillimi i Novelës Angleze	II	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Poezia Angleze	II	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Studime në dramë	II	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Lëndë me Zgjedhje																			
Autobiografi dhe letërsi artistike	II	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151

Studime të avancuara në përkthim	II	6	5	64	66	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	66	20	150
Lëndë me Zgjedhje																		
Letërsia fantastiko shkencore	II	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Vepra Shekspirite	II	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Totali		60	50	640	619										640	619	250	1509

Viti I Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore												Orë në auditor	Punë e Pavarur	Provime	Gjithsej
			Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë						
			ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
Metoda Kërkimore	I	7	6	64	86	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	86	25	175
Teoria e Gjuhesise	I	6	5	64	62	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	62	25	151
Seminar pasuniversitar	I	8	0	0	0	7	64	117	0	0	0	0	0	0	64	117	20	201
Projekt	I	9	7	64	104	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	104	55	223
Tezë	II	30					16	734							16	734		750
Totali		60	18	195	211	7	80	277							272	1103	125	1500

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 832 orë në auditor dhe 872 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 80 orë në auditor dhe 277 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 45 orë në auditor dhe 375 orë punë e pavarur e studentit

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lënda /Moduli		Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/ grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1.	Metoda Kërkimore	Ahmet Ecirli	Dr.	Shkenca Edukimi	PAE
2.	Qasje në Kritikën Letrare	Bavjola Shatro	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
3.	Teoria e Gjuhësisë	Yakup Cetin	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAE
4.	Letërsi dhe Kulturë Britanike	Rregjina Gokaj	Dr	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
5.	Letërsi dhe Kulturë Amerikane	Artur Jaupaj	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
6.	Letërsi Post Koloniale	Tidita Abdurrahmani	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
7.	Psikolinguistike	Elida Tabaku	Prof.Ass.Dr.	Gjuhë dhe Letërsi	PAK
8.	Metoda Kërkimore	Ahmet Ecirli	Dr.	Shkenca Edukimi	PAE
9.	Qasje në Kritikën Letrare	Bavjola Shatro	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
10.	Teoria e Gjuhësisë	Yakup Cetin	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAE
11.	Letërsi dhe Kulturë Britanike	Rregjina Gokaj	Dr	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
12.	Letërsi dhe Kulturë Amerikane	Artur Jaupaj	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
13.	Letërsi Post Koloniale	Tidita Abdurrahmani	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
14.	Psikolinguistike	Elida Tabaku	Prof.Ass.Dr.	Gjuhë dhe Letërsi	PAK
15.	Metoda Kërkimore	Ahmet Ecirli	Dr.	Shkenca Edukimi	PAE
16.	Qasje në Kritikën Letrare	Bavjola Shatro	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAK
17.	Teoria e Gjuhësisë	Yakup Cetin	Dr.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	PAE

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës

- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

U shqyrtuan programet e lëndëve dhe ato përgjithësisht përmbajnë elementet e mësipërme.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret/standardet
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.		
Kriteri 1	Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	<p>Kriteri 1: Programi <i>Master Shkencor</i> në gjuhë dhe letërsi angleze është në proces akreditimi. Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo parashikohet edhe në nenin 10 të Rregullores mbi studimet e ciklit të dytë <i>Master i shkencave</i> në gjuhë dhe letërsi angleze. Programi zhvillohet në përputhje me programin e licensuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Kriteri 2: Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një programi master Shkencor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze me kohë të plotë është 60.</p>
Kriteri 2	Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.		
Kriteri 2	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	<p>Kriteri 2: Sipas rregullores mbi studimet e ciklit të dytë programi i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional.</p> <p>Kriteri 3: Programi i studimeve “Master i Shkencave” synon të zgjerojë njohuritë e fituara në</p>
Kriteri 3	Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	
Kriteri 4	Programet e integruara të studimeve të	

<p>Kriteri 5</p> <p>Kriteri 6</p> <p>Kriteri 7</p>	<p>ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Kriteri 4: SHLHPB, aktualisht, nuk ofron programe studimi të ciklit të dytë të integruara në fushat e mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, veterinarisë, arkitekturës.</p> <p>Kriteri 5: Programi i studimeve të këtij cikli i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij.</p> <p>Kriteri 6: Programi i studimeve “Master i Shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>Kriteri 7: Programi i studimeve “Master Profesional” nuk është objekt i këtij vlerësimi.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Kriteri 1: Politikat dhe programi i ofruar nga SHLHPB është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.</p> <p>Kriteri 2: Programi i studimeve synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>		

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Kriteri 1: Në bazë të kurrikulës dhe programeve lëndore përkatëse, si dhe objektivat të programit të shprehura në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë <i>Master</i> në gjuhë dhe letërsi angleze, neni 3 i saj, vihet re se përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen.</p> <p>Kriteri 2: Metodat e vlerësimit shprehen qartë në programet lëndore, ndërkohë që çdo pedagog është i lirë të organizojë vlerësimin në përqindje të ndryshme të këtyre zërave. Zërat e vlerësimit të përcaktuara janë: gjysëm-finale, kuize, projekte, projekte semestrale, pjesëmarrje në mësim dhe provimi përfundimtar.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p>	<p>Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Kriteri 1: Në hartimin e kurrikulave, stafi i angazhuar është shprehur se ka studiuar dhe analizuar kurrikulat e universiteteve me përvojë të gjatë në këtë fushë, duke i përshtatur ato me kushtet e tregut të punës në Shqipëri.</p> <p>Kriteri 2: Siç vihet re edhe në programet lëndore dhe kurrikulat në përgjithësi, programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese, si nga ana teknike (kredite evropiane, kredite amerikane, metoda vlerësimi), ashtu edhe nga ana e përmbajtjes (plani mësimor, literatura etj.).</p> <p>Kriteri 3: Programet e studimit në ciklin e dytë janë hartuar në përputhje me kartën e Bolonjës dhe kërkesat e saj.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>		

Kriteri 1	Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Kriteri 1: Programi mësimor i programeve të ciklit të dytë, përveç anës teorike dhe angazhimit në çdo lëndë në punë kërkimore, përfshin gjithashtu edhe përgatitjen e tezës, e rëndësishme kjo për zhvillimin individual të studentit në fushën e kërkimit shkencor.
Kriteri 2	Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Kriteri 2: Programi i studimeve hartohet në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim.
Kriteri 3	Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;	Kriteri 3: Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programit të studimeve kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe botime shkencore.
Kriteri 4	Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.		
Kriteri 1	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Kriteri 1: Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” nuk përbën objekt të këtij vlerësimi.
Kriteri 2	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Kriteri 2: Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” nuk përbën objekt të këtij vlerësimi.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.		
Kriteri 1	Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Kriteri 1: Programi i studimeve merr parasysh nevojat e tregut të punës dhe hartohet në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.
Kriteri 2	Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	Kriteri 2. Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, ka kryer një studim të nevojave të tregut të punës.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.		
Kriteri 1	Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të	Kriteri 1: Kurrikula e programit “Master i Shkencave” përfshin 120 ECTS, nga të cilat 30 ECTS i janë kushtuar projektit kërkimor, kusht ky për diplomim. Kohëzgjatja normale e

	studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	programit është 2 vite akademike, i ndarë në 4 semestra.
Kriteri 2	Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Kriteri 2: Programi i studimeve “Master Profesional” nuk është objekt i këtij vlerësimi.
Kriteri 3	Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Kriteri 3: SHLHPB, aktualisht, nuk ofron programe të integruara të ciklit të dytë.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.		
Kriteri 1	Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Kriteri 1: Në Rregulloren e programit të studimit Master Shkencor në gjuhë dhe letërsi angleze shprehet mënyra e diplomimit të studentit brenda afateve të parashikuara. Kriteri 2: Kurrikula e programit “Master i Shkencave” parashikon 120 ECTS, nga të cilat 30 ECTS i janë kushtuar projektit kërkimor, kusht ky për diplomim.
Kriteri 2	Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.		
Kriteri 1	Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Kriteri 1: Çdo pedagog në orën e parë të kursit bën prezantimin e programit të lëndës. Ndërkohë, ai gjendet edhe në faqen e internetit të SHLHPB-së. Kriteri 2: Informacioni për programin e studimit, modulet dhe programet lëndore ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. Programet lëndore gjenden në faqen e internetit të SHLHPB-së.
Kriteri 2	Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Grupi i vlerësimit të jashtëm, pas analizës së të dhënave, del në përfundimin se përmbushen kriteret e përcaktuara për programin e studimit.		

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i

mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies

Format kryesore të procesit mësimor në programin e studimit *Master i shkencave* në gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit në SHLHPB janë leksionet, seminarët, projektet, e parashikuar kjo në nenin 6 të rregullores mbi këtë program studimi. Në Departamentin e Gjuhë dhe Letërsisë Angleze në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) leksionet dhe seminarët zhvillohen në mënyrë të integruar. Numri i kufizuar i studentëve në auditor dhe politika e frekuentimit të detyrueshëm në masën 70 % të të gjithë aktivitetetëve mësimore bënë të mundur një formë të tillë mësimdhënie. Kjo formë gjithashtu mundëson praktikat bashkëkohore të mësimdhënies interaktive ku studentët nuk janë pasivë por bëhen përgjegjës për procesin mësimor.

Semestri i katërt për Msc në gjuhë dhe letërsi angleze i është rezervuar përgatitjes së diplomës.

Ngarkesa mësimore

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bërë në përputhje me udhëzimet e marra nga Ministria Arsimit dhe Shkencës, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar si dhe udhëzimet respektive të MASH. SHLHPB i kushton një rëndësi të veçantë përzgjedhjes së stafit akademik, duke synuar përputhjen e interesave të tyre me programet që ofrohen. Duke plotësuar të gjitha standardet e parashikuara në legjislacionin shqiptar në lidhje me numrin e stafit akademik për çdo department, SHLHPB ka punësuar edhe staf me kohë të pjesshme i cili angazhohet në disa fusha, të cilat synohen që në vitet në vijim të mbulohen nga stafi me kohë të plotë.

Cilësia e mësimdhënies

Departamenti, në bazë të kurrikulës i paraqet çdo anëtar të stafit akademik formatin bazë të programit lëndor të përdorur nga institucioni, ku përfshihen të gjitha detajet në lidhje me mbarëvajtjen e zhvillimit të lëndës. Pedagogu propozon brendinë apo ndryshimet e mundshme në programin lëndor, ku përfshihen në mënyrë të detajuar: qëllimi i lëndës, objektivat, bibliografia e detyrueshme, bibliografia e rekomanduar etj. Dosja me karakteristikat e çdo lënde studjohet në nivel departamenti dhe pasi shihet se është në përputhje me modelin e fakultetit dhe departamentit, merr miratimin e tij.

Departamenti analizon të dhënat e anketimeve të zhvilluara me studentë për përmirësim të kurrikulës dhe të stafit akademik.

Kontrolli i njohurive, format e kontrollit, objektivat në vlerësimin e studenteve

Programi i Studimit Master Shkencor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	
Format e kontrollit	Përqindja e vlerësimit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10-50 %
Testimet gjatë vitit	20-40 %
Provimi përfundimtar	30-50%
Etj	
Në total	100%

Kryesisht, nota përfundimtare e çdo lënde synohet të jetë e përbërë nga disa zëra, siç janë provimi gjysëmfinal, pjesëmarrja në klasë, detyra apo projekte, provimi përfundimtar etj, secili prej tyre me një ngarkesë të vendosur më parë.

Format e kontrollit dhe formula e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë, është prezantuar në plan-programin e secilës lëndë. Në fillim të çdo semestri pedagogët u bëjnë të ditur studentëve modelin dhe formulën e zgjedhur për vlerësimin e njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës sipas një formati të përcaktuar nga institucioni.

Koha mesatare e zgjatjes së studimeve

Afati minimal i studimeve në programin e studimeve *Master shkencor* është 2 vjet i ndarë në 4 semestra dhe afati i fundit është 4 vjet, 8 semestra akademike.

Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies

Programi i Studimit Master Shkencor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	832
Seminare	80
Ushtrime	0
Laboratore	0
Praktikë lëndore	0
Praktikë profesionale	0
Etj	
Në total	912

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	5
Për projekte shkencore në rang Departamenti	
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	25
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	

Tregues të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
 - Leksione
 - Seminare
 - Ushtrime
 - Laboratore
 - Praktikë lëndore
 - Praktikë profesionale
 - Etj

- Format e kontrollit të njohurive
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Kushtet për pranimin e studentëve dhe procedurat e përzgjedhjes

Për t'u pranuar në programin e studimeve "Master i shkencave" në gjuhë dhe letërsi angleze, çdo shtetas shqiptar apo i huaj që aplikon nevojitet të ketë përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit *Bachelor*. Preferohen ata studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit *Bachelor* në programin e studimit të gjuhë dhe letërsisë angleze ose programe të ngjashme. Pranoen për t'u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" ose "Master profesional" shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë këto kushte:

i. vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e studimeve të ciklit të parë me gradën *Bachelor* në Shqipëri ose jashtë shtetit (barasvlerësuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës);

ii. plotësojnë kushtet e tjera të pranimit, të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Shkollës së Lartë;

iii. pranojnë pagesën e tarifës së caktuar mujore ose vjetore.

Përzgjedhja e kandidatëve në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve bëhet nga Komiteti Shkencor, i cili përbëhet nga:

- drejtori i Zyrës së Përzgjedhjes dhe Pranimit;
- përgjegjësi i departamentit në të cilin studenti aplikon;
- dekani i studentëve;
- kancelari.

Lejohet transferimi i studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta/universitetet, vendase ose të huaja, publike ose private, në Shkollën e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër) dhe anasjellas dhe brenda programeve të studimeve të Shkollës së Lartë, pasi të bëhet barasvlerësimi i provimeve, sipas planeve mësimore përkatëse. Transferimi lejohet ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh.

Regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2012-2013 dhe analiza

Gjatë vitit akademik 2012-2013 janë regjistruar gjithsej në këto programe 6 studentë.

Numri i studentëve për çdo program studimi

Numri i studentëve për çdo program studimi	
Programi i studimit	Program "Master i shkencave" 2012-13
Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi angleze	6

Regjistrimi i studentëve në bazë të gjinisë

	2012-2013		Gjithsej
	M	F	
Master i shkencave në gjuhë dhe letërsi angleze	4	2	6

Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)
- Nota Mesatare

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)
- Nota Mesatare
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- Të dhëna për punësimin e studentëve
- Numri total të diplomuarve
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)
- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
- etj

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p> <p>Kriteri 5</p>	<p>Kriteri 1: Studentët që ndjekin programet e studimeve Master i Shkencave në “Gjuhë dhe letërsi angleze” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Kriteri 2: Programi në fjalë është program i studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 3: Nga verifikimet e kryera në institucion rezulton se studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni.</p> <p>Kriteri 4: Siç është parashikuar në Rregulloren e Ciklit të Dytë, studentët e këtij programi studimi duhet të japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programin “Master i Shkencave” niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve.</p> <p>Kriteri 5: Parashikuar në Planin Strategjik të Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), kapitulli 4, pika F/1 dhe F/2, ISHLHPB vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Kriteri 1: Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtij programi.</p> <p>Kriteri 2: Studentëve nëpërmjet Zyrës së Përzgjedhjes dhe Pranimit të Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion.</p> <p>Kriteri 3: Studentëve nëpërmjet zyrës së karrierës që funksionon pranë dekanatit të studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Kriteri 1: SHLHPB aktualisht nuk disponon të diplomuar. Në të ardhmen planifikohet ngritja e një zyre e cila do të realizojë statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar.</p> <p>Kriteri 2: Nuk ka përfunduar ende viti i parë i programit të studimit. Megjithatë, ekziston një Zyrë për Përzgjedhjen dhe Pranimin e Studentëve së bashku me Sekretarinë Mësimore një nga funksionet e të cilave është hartimi i statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, apo mospërfundimit me sukses të vitit akademik.</p> <p>Kriteri 3: Sekretaria mësimore disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi e në vazhdim.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>		

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Kriteri 1: Programi i studimeve nuk ka përfunduar ende.</p> <p>Kriteri 2: Programi i studimeve nuk ka përfunduar ende.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Kriteri 1: I gjithë procesi i akreditimit është bërë i njohur si për studentët ashtu edhe për anëtarët e stafit akademik dhe administrativ. Njoftimi është bërë në bazë njësishe dhe nëpërmjet lajmërimeve në faqen e internetit të SHLHPB, ku është vendosur linku që drejton studentët në faqen e APAAL-it. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit.</p> <p>Kriteri 2: Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Linku i APAAL-it, i vendosur në faqen e internetit të SHLHPB-së, mundëson ndjekjen transparente të procesit.</p> <p>Kriteri 3: Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Kriteri 1: Studentëve nëpërmjet zyrës së karrierës që funksionon pranë dekanatit të studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit dhe ndjekia e ecurisë së tyre, si dhe u ofrohet ndihmë për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Kriteri 2: Nuk parashikohet praktikë profesionale në këtë program studimi.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Pas përfundimit të shqyrtimit të kritereve të kërkuara GVJ-ja arrin në përfundimin se standardet e vendosura plotësohen nga programi i studimit Master i Shkencave në Gjuhë e Letërsi Angleze.</p>		

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor **Pjesa përshkrimore**

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor
- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- Numri i projekteve kërkimore të fituara
- Numri i projekteve të zbatuara
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimeve Kombëtare
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

Politikat e kërkimit shkencor

Shkolla inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e stafit akademik vlerësohen nga një juri e posaçme në bazë të kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren për Nxitjen e Publikimeve Shkencore” të Shkollës, duke u mbështetur në kriteret përkatëse. Çdo vit, Këshilli Administrativ i Shkollës vendos masën e shpërblimit për çdo pikë të fituar dhe në bazë të pikëve të mbledhura, çdo anëtar i stafit akademik përfiton shpërblimin përkatës.

Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) ofron gjithashtu mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.		
Kriteri 1	Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;	Kriteri 1: Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; Kriteri 2: Personeli akademik nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.
Kriteri 2	Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.		

Kriteri 1	Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Kriteri 1: Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj.
Kriteri 2	Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Kriteri 2: Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.		
Kriteri 1	Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;	Kriteri 1: Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;
Kriteri 2	Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Kriteri 2: Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.		
Kriteri 1	Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Kriteri 1: Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
Kriteri 2	Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Kriteri 2: Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
Kriteri 3	Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	Kriteri 3: Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në institucion Grupi i Vlerësimit të Jashtëm del në përfundimin se standardet e kërkuara përmbushen nga ky program studimi.		

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
 - Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
 - Organizatat Profesionale
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës
- Dokumentacioni përkatësi marrë nga vizita në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.		
Kriteri 1	Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Kriteri 1: Programi i studimit në fjalë është Master i Shkencave.
Kriteri 2	Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	Kriteri 2: Programi nuk ofron praktikë profesionale, por zhvillohen aktivitete me natyrë praktike si veprimtari ekstrakurrikulare. Institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Grupi i vlerësimit të jashtëm del në përfundimin se programi i studimit plotëson standardet e vendosura.		

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVJ**” sipas metodës **SWOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. PIKA TË FORTA:

- 1) Programi “Master i shkencave” në “Gjuhë dhe letërsi angleze”, për shkak të natyrës së tij të profilizuar, është në përputhje me nevojat e tregut të punës për specialistë të gjuhës dhe letërsisë angleze dhe përmbush objektivat e parashtruara në këtë program studimi.
- 2) Mësimdhënie në gjuhën angleze. Mësimdhënia në departamentin e gjuhë dhe letërsisë angleze zhvillohet në gjuhën angleze. Këtë e bën të domosdoshme dhe karakteri ndërkombëtar i studentëve dhe pedagogëve. Kjo mënyrë mësimdhënie u jep mundësi studentëve për përgatitje më të mirë profesionale.
- 3) Bashkëpunimi me institucione arsimore dhe biznese brenda dhe jashtë vendit. Bashkëpunimet me universitete të huaja dhe institucione që ofrojnë asistencë profesionale praktike për studentët.
- 4) Sistemi i automatizimit. Publikimi online i të dhënave rrit transparencën dhe cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik.
- 5) Bursat për studentët. Bursat për studentët shërbejnë si një element i rëndësishëm motivues.
- 6) Infrastruktura logjistike dhe IT. SHLHPB është e pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor. Infrastruktura logjistike dhe IT është e standarteve të larta.
- 7) Zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median. Zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe pasqyrimin korrekt të veprimtarive të institucionit.
- 8) Organizimi i programeve trajnuese për stafin. Institucioni organizon vazhdimisht seminare dhe aktivitete trajnuese në funksion të përmirësimit dhe zhvillimit të stafit.
- 9) Numri i vogël i studentëve në klasa. Ky element ndikon pozitivisht në mbarëvajtjen e procesit mësimor.

b. PIKA TË DOBËTA:

- 1) Institucion relativisht i ri. Të qenit institucion i ri krijon vështirësi në realizimin e disa prej kriterëve.
- 2) Mungesa në stafin akademik sipas fushave të veçanta të specializimit. Rekomandohet që fushat e caktuara të studimit të mbulohen me staf akademik të profilizuar.
- 3) Mosmbulimi me 70 përqind të mësimdhënies nga stafi akademik efektiv. Mbulimi 70 përqind i programit të studimit me staf akademik efektiv nuk është realizuar.
- 4) Programi i studimit këshillohet të përputhet edhe më shumë me objektivat e tij të punësimit.
- 5) Ndërthurje jo tërësisht e balancuar midis lëndëve të formimit letrar dhe gjuhësor.

c. MUNDËSITË:

- 1) Financimi nga projekte brenda dhe jashtë vendit.
- 2) Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe perspektiva për ndërtimin e kampusit universitar.
- 3) Ngritja e qendrës së gjuhëve të huaja, si një element i rëndësishëm për ecurinë e programit.
- 4) Përfshirja e praktikës profesionale të studentëve në programin e studimit.
- 5) Pasurimi i bibliotekës me literaturën e nevojshme për realizimin e programit.

d. PENGESAT:

- 1) Të qenurit një institucion i ri. Kjo përbën një pengesë në një treg të gjerë Institucionesh të Arsimit të Lartë.
- 2) Mungesa e programeve të ciklit të tretë. Kjo ka zbehur deri diku mirëfunksionimin e disa qendrave kërkimore-zhvillimore, objekt i të cilave është realizimi i veprimtarive mësimore-shkencore, kryesisht në programet e këtij cikli.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Dr. Violeta Shaba

2. Dr. Leonard Danglli